



4-5 Tetor 2023



Në datat 4-5 tetor 2023, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor është zhvilluar forumi i diskutimeve mes trupës gjyqësore dhe asaj të prokurorisë mbi zbatimin e marrëveshjes së transferimit të të dënuarve midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë.

Ky forum u organizua nga Ambasada Britanike në Tiranë, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, në kuadër të ratifikimit të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe

Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe, dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar.

Paneli i këtij forumi përbëhej nga znj. Naureda Llagami, kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Paul Goldspring, ekspert i lartë gjyqësor i Mbretërisë së Bashkuar, z. Yaser El Borgi, zëvendës drejtor i Drejtorisë së Burgjeve dhe Shërbimit të Provës në Mbretësinë e Bashkuar, përfaqësues nga Ambasada Britanike si dhe nga Ministria e Drejtësisë, gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve.

Në fokus të këtij aktiviteti ishte prezantimi i magistratëve me një tablo të përgjithshme të kuadrit ligjor, parimeve dhe politikave të sistemit të dënimeve penale në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Shqipëri. Gjatë forumit, pjesëmarrësit adresuan pyetje mbi konstatimet praktike që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes si dhe problematikat e hasura në përditshmëri.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar plotësisht të mbështesë zbatimin e plotë të detyrimeve që burojnë nga kjo marrëveshje.

06 Tetor 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka ndjekur me vëmendje kërcënimet e adresuara ditët e fundit ndaj funksionarëve të sistemit të drejtësisë, është plotësisht i angazhuar për të mbështetur në mënyrë të palëkundur, çdo gjyqtar e prokuror, i cili me përkushtim, profesionalizëm, integritet dhe përgjegjësi të lartë, punon çdo ditë dhe më shumë, për të bërë vendin të sigurt për ne dhe brezat që do të vijnë pas.

Në një shoqëri demokratike, gjyqtarët dhe prokurorët janë garantues të drejtësisë dhe barazisë para ligjit dhe si të tillë, ata duhet të ushtrorin funksionet e tyre në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe profesionale për të merituar besimin e publikut. Për këtë arsye të gjithë së bashku, për të garantuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor, duhet të ndalim çdo sulm apo veprim që synon të cenojë së pari jetën, integritetin, sigurinë dhe paprekshmërinë e magjistratëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkohet me aktorë të tjerë dhe njëzëri, dënon çdo përpjekje për të kërcënuar, kufizuar, apo ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, gjyqtarët dhe prokurorët në përmbushjen e detyrave të tyre kushtetuese dhe ligjore. Çdo përpjekje e tillë është një kërcënim serioz për shtetin e së drejtës dhe demokracinë në vend, pasi minon përpjekjet tona të përbashkëta drejt integritetit evropian.

09 Tetor 2023



Më datë 09.10.2023, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve për zgjedhjen e tre anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilët do të zëvendësojnë tre prej anëtarëve që u përfundon mandati, përkatësisht për dy gjyqtarë nga gjykatat e shkallës së parë dhe një gjyqtar nga gjykatat e apelit

Aktiviteti u përshëndet nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, e cila theksoi se: "Sfida e atyre që sot kandidojnë dhe atyre që ju do t'i zgjidhni për t'ju përfaqësuar në Këshill është, që përveç dëshirës për të kontribuar duhet, të kenë edhe aftësinë për t'u përballur me sfidat e reja! Sfidën e qendrueshmërisë! Sfidën e vazhdimësisë! Sfidën e nostalgjisë ndonjëherë edhe ndaj së kaluarës! Sfidën e profesionalizmit dhe cilësisë së shërbimit që kërkohet dhe pritët nga të gjithë!"

Znj. Llagami, e përfundoi fjalën e saj duke i uruar suksese kandidatëve dhe falenderoj të gjithë gjyqtarët të cilët kanë punuar me përgjegjshmëri dhe përkushtim pavarësisht vështirësive.

Në vijim, kandidatët gjyqtarë për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, prezantuan shkurtimisht platformat e tyre duke njohur të gjithë pjesëmarrësit me motivimin dhe vizionin e secilit.

Në përfundim të procedurës së votimit, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, zgjodhi tre anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- Z. Markelian Koça, nga gjykatat e shkallës së parë;
- Znj. Gentiana Muçaj, nga gjykatat e shkallës së parë;
- Znj. Emona Muçi, nga gjykatat e apelit.

11 Tetor 2023



Më datë 11.10.2022, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami u takua me një trup prej 50 gjyqtarësh nga Austria. Në fokus të takimit ishte njohja mbi rolin, funksionet dhe kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe prezantimi i shkurtër i ecurisë së reformës në drejtësi. Gjithashtu, në këtë takim të pranishmit diskutuan edhe mbi shkëmbimin e përvojave dhe eksperiencave në mes të dy vendeve me qëllim të krijimit të një sistemi gjyqësor sipas standardëve ndërkombëtare.

18 TETOR 2023



Në datën 18.10.2023, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami mori pjesë në akademinë "Citizen in Charge", që u organizua nga organizata Qëndresa Qytetare në bashkëpunim me Ambasadën Holandeze në Tiranë, në të cilën morën pjesë 30 studentë të drejtësisë, ekonomisë dhe fushave të tjera.

Në fokus të bashkëbisedimit me të rinjtë ishte prezantimi i veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, si një nga institucionet e reja të krijuara nga reforma në drejtësi si

dhe prezantimi i hartës së re gjyqësore, impakti dhe risitë që sjell ky projekt për sistemin gjyqësor.

Takimi u përmbyll me një diskutim të hapur me pyetje dhe përgjigje konkrete.

20 TETOR 2023



Më datë 20 tetor 2023, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u organizua ceremonia e betimit të 40 gjyqtarëve të cilët përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023.

Gjyqtarët e rinj, të sapo emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tashmë i bashkohen korpusit të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në gjykatat e vendit.

Në këtë aktivitet publik morën pjesë magistratët e rinj, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Alfred Balla, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës z. Arben Rakipi, si dhe përfaqësues të mediave.

Të pranishmit në këtë aktivitet u përshëndetën nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami, e cila e cilësoi ditën e sotme si një hap vendimtar për rijetësimin e sistemit tonë gjyqësor, i cili vjen pas finalizimit të proceseve të rëndësishme siç është ngritja në detyrë dhe promovimi i gjyqtarëve aktual që po shërbejnë brenda sistemit në ditët e tij më të vështira.

Në fjalën e saj, znj. Naureda Llagami shprehu se “promovimi mbi meritokracinë është thelbi i krijimit të një trupe gjyqësore profesionale, të pavarur dhe me integritet dhe kjo gjë ka kërkuar shumë përpjekje nga ana jonë pasi kur e nisëm rrugëtimin tonë përpara 5 viteve nuk kishim asnjë model se si duhet të krijoheshin këto standarde”.

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor përfundoi fjalimin me urimin “ju uroj suksese në rrugëtimin tuaj profesional që ju pret përpara duke kultivuar durim dhe përlësi, sepse drejtësia dhe e vërteta e gjejnë rrugën e tyre”.

Ceremonia vijoi me betimin e gjyqtarëve znj. Ina Yzellari, z. Klajdi Tërova, znj. Aurora Alimadhi, znj. Olta Cenaj, z. Estjon Venxha, znj. Edlira Çota, z. Elvis Sulejmani, z. Vladimir Cjapi, z. Noel Veizi, z. Renis Sheshi, z. Aldi Kareco, z. Genci Busho, z. Artan Çirraga, znj. Alba Ngresi, znj. Dorentina Mulaj, znj. Klodiana Kryeziu, znj. Eranda Cufo, z. Armand Shkurta, z. Fjoral Behari, znj. Edona Vajushi, znj. Eglantina Biba, z. Mikel Hysometaj, znj. Dorina Alushi, z. Lirim Bulica, znj. Juliana Pjetri, znj. Egla Mirashi, znj. Nertila Përallaj, znj. Elona Mërtiri, znj. Anisa Brinja, znj. Elena Tafa, znj. Lumturi Zhupa, z. Ilirjan Hysa, znj. Entela Selmanaj, z. Entiljano Spahiu, z. Ervin Kore, z. Romeo Merruko, znj. Mevlute Çausi, z. Orald Hoxha, znj. Ajshe Xhafa, znj. Enkeleda Halilaj, sipas tekstit: “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale.

17 NËNTOR 2023



Në datë 17 nëntor 2023, në qytetin e Vlorës, Këshilli i Lartë Gjyqësor prezantoi sistemin e ri online për matjen e cilësisë të shërbimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nëpërmjet anketave të përdoruesve të gjykatës.

Matja e kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës, në lidhje me aspektet kyçe të shërbimit të drejtësisë, synon të rrisë përgjegjshmërinë dhe reagimin e administratës të gjykatës, si dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin znj. Guilia Re shefe e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, znj. Tidita Fshazi përfaqësuese e delegacionit European në Shqipëri, znj. Laura Muca menaxhere e SEJ IV, znj. Marçela Shehu anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, z. Enkel Peza zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe znj. Emirjana Dimo gjyqtare e Medias e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Kjo iniciativë e Këshillit të Lartë Gjyqësor u mundësua me mbështetjen e projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Forcimi i cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Shqipëri (SEJ IV)”, pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” – Faza III.



Në datën 16 dhe 17 nëntor 2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me mbështetjen e projektit “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ IV), pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2023-2026”, zhvilloi trajnimin me temë “Komunikimi i gjyqësorit me median dhe publikun”.

Të pranishëm në këtë trajnim ishin znj.

Marçela Shehu anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, znj. Laurela Muca menaxhere e SEJ IV, znj. Rusudan Kvachantiradze eksperte ndërkombëtare dhe eksperte komunikimi e CEPEJ, z. Jasa Vrabec ekspert ndërkombëtar i CEPEJ dhe anëtar i GT-EVAL, gjyqtarët e caktuar për median si dhe koordinatorët për të drejtën e informimit të caktuar në gjykata.

Gjatë takimit pjesëmarrësit patën mundësinë të ndjekin sesione profesionale, inovative dhe interaktive mbi komunikimin e gjyqësorit me median, ku ekspertët ndërkombëtarë ndanë eksperiencën e tyre duke demonstruar sukseset dhe diskutuan rreth sfidave aktuale.

22 NËNTOR 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ i ngarkuar nga Kushtetuta për të garantuar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, ka ndjekur me vëmendje zhvillimet e fundit sa i përket deklaratave nga persona publik dhe disa shkrimeve të publikuara në media, të cilat në përmbajtjen e tyre çënojnë rëndë figurën dhe dinjitetin e gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Këshilli vëren me keqardhje se këto publikime reflektojnë vetëm disa shembuj të sulmeve mediatike, të pajustificuara ndaj gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, si dhe përbëjnë sulm ndaj gjyqtarëve për shkak të detyrës, duke synuar intimidimin, kërcënimin dhe ndikimin e paligjshëm të tyre nëpërmjet përndjekjes mediatike.

Njëkohësisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se këto qëndrime jo vetëm që ndikojnë negativisht në besimin e publikut ndaj pushtetit gjyqësor por edhe krijojnë imazhin e gabuar mbi veprimtarinë e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të detyrës me synimin për t'i detyruar ata të japin vendime në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton të gjithë aktorët të respektojnë gjyqtarët dhe impenjimin e tyre në forcimin e shtetit të së drejtës, pasi dhënia e drejtësisë duhet të jetë e çliruar nga çdo lloj ndikimi apo ndërhyrjeje nga subjektet publike apo private.

Në respektim të dispozitave ligjore në fuqi, sjellim në vëmendje se mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë.



Në datat 23 – 24 nëntor, në kuadër të zbatimit të projektit EU4Justice, Këshilli i Lartë Gjyqësor organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë “Rritja e transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e sistemit gjyqësor”, në qytetin e Vlorës.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Arturo Valdés

dhe z. Arben Lila përfaqësues të Projektit EU4Justice si dhe zëvendëskryetarët respektivë të gjykatave.

Qëllimi i kësaj tryeze të rrumbullakët ishte forcimi i dialogut konstruktiv midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave për të mundësuar vlerësimin dhe adresimin më të mirë të sfidave dhe kërkesave që lidhen me transparencën dhe vizibilitetin publik të veprimtarisë gjyqësore.

Në tryezë u zhvilluan diskutime të hapura dhe proaktive midis pjesëmarrësve, me fokus të veçantë hartimin e një sërë masash efektive për të rritur transparencën e sistemit gjyqësor, duke forcuar kështu besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

6 DHJETOR 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor në Mbledhjen Plenare të datës 06.12.2023, në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore, miratoi Udhëzuesin Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, i cili synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media, të veprimtarisë gjyqësore nëpërmjet standardizimit të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median.

Ky akt i rëndësishëm u hartua nga grupi i punës i ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me mbështetjen e projekteve të asistencës teknike, si ai i zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim (EWMI) i financuar nga INL, Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri (SEJ IV), si dhe nga INFOÇIP me mbështetjen e veçantë të Ambasadës Holandeze në Shqipëri.

Udhëzuesi i është nënshtruar procesit të konsultimit publik me gjyqtarët e medias, gazetarët, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me organizatat e shoqërisë civile, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar maksimalisht për rritjen e transparencës së gjykatave dhe forcimin e marrëdhënieve me median, me qëllim rritjen e besimit të publikut te drejtësia.

12 DHJETOR 2023



Në datën 12.12.2023, u zhvillua ceremonia e mirëseardhjes dhe fillimit të detyrës së re për anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve në datën 09.10.2023



Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Emona Muçi, zgjedhur nga gjykatat e apelit, znj. Gentiana Muçaj dhe z. Markelian Koça zgjedhur nga gjykatat e shkallës së parë.



Në fjalën e saj përshëndetëse, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami ju uroi mirëseardhjen tre anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor duke i uruar suksese në kuadër të përmbushjes së detyrave kushtetuese dhe çuarjen më tej të proceseve të rëndësishme në sistemin gjyqësor.

Njëkohësisht, znj. Llagami falenderoi tre anëtarët të cilët përfunduan sot mandatin, znj. Brikena Ukperaj, znj. Marçela Shehu dhe z. Dritan Hallunaj, për punën e kryer dhe kontributin e vyer dhënë përgjatë këtyre viteve. Në përfundim të mbledhjes plenare të zhvilluar sot, Këshilli vendosi deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të znj. Brikena Ukperaj, znj. Marçela Shehu dhe z. Dritan Hallunaj.

22 DHJETOR 2023



Kryetarja e Këshilli i Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami priti në një takim miqësor Ambasadorin e Holandës në Tiranë, SH.T. Reinout Vos. Ai shoqërohej në këtë takim nga Këshilltarja për Shtetin e së Drejtës Znj. Edlira Osmani. Në këtë takim gjithashtu ishte i pranishëm edhe Drejtori i INFOCIP, Z. Gerti Shella.



Në takim u diskutua për klimën e shkëlqyer të bashkëpunimit mes KLGJ dhe partnerëve ndërkombëtarë që ofrojnë asistencën e tyre në mbështetje të Reformës në Drejtësi.

Kryetarja e KLGJ, Znj. Llagami falenderoi Ambasadorin Vos për ndihmën cilësore të ofruar dhe shprehu besimin se bashkëpunimi do të njohë rritje në vitin 2024.

Drejtesi i INFOCIP, Gerti Shella falenderoi KLGJ për rezultatet e bashkëpunimit në kuadër të Projektit “Open Court through Press Judges”. KLGJ dhe INFOCIP kanë ndërvepruar që prej vitit 2021 në partneritet përmes një Memorandumi Bashkëpunimi, të firmosur mes palëve në dt 14. 04.2021. Ky program u mbështet nga Ambasada Holandeze – Embassy of the Netherlands in Albania.

Një ndër objektivat e këtij bashkëpunimi ka qenë nxitja e shkëmbimeve profesionale mes gjyqtarëve holandezë të medias dhe gjyqtarëve shqiptarë të medias. Po ashtu, pjesë e rezultateve konkrete të projektit ka qenë miratimi i udhëzuesit standard Media-Gjykatë, i cili u miratua në nga KLGJ në datë 6 dhjetor 2023. Shella raportoi si të përmbushura me sukses të gjitha objektivat e bashkëpunimit të përcaktuara në Memorandumin mes palëve.

- Në kuadër të procesit të vlerësimit etiko profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë **3 mujorit të katërt të vitit 2023** vendosi lidhur me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për **17 gjyqtarë**.
- Këshilli vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për **4 gjyqtarë** për periudhën 2017-2019 dhe për **6 gjyqtarë** për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Gjithashtu, Këshilli miratoi raportet për vlerësimin etik dhe profesional të **2 gjyqtarëve** për vitin 2019, të **1 gjyqtari** për vitin 2021, të **2 gjyqtarëve** për vitin 2022 si dhe të **1 gjyqtari** për vitin 2020-2022.
- Këshilli vendosi për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të **1 gjyqtari** për periudhën e vlerësimit 2013-2016.
- Këshilli, pasi shqyrtoi projektvendimet lidhur me ngritjen në detyrë të **2 kandidatëve** në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, vendosi shtyrjen e shyrtimeve për kryerjen e verifikimeve të tjera shtesë.
- Këshilli miratoi vendimet për renditjet për ngritje në detyrë në **Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë** për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 183, nr.184 dhe nr.185 datë 28.05.2020.
- Këshilli miratoi vendimet për ngritje në detyrë në **Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë** për gjyqtarët **znj. Marsela Pepi, z. Qemal Zaimi dhe znj. Alma Kolgjoka**.
- Në respektim të dispozitave ligjore, Këshilli vendosi përfundimin e afatit të komandimit si inspektore pranë ILD për **znj. Marsela Pepi** dhe përfundimin e komandimit si nëpunës përgjegjës në njesinë e vlerësimit profesional dhe etik të magjistratit pranë KLGJ-së për **z. Qemal Zaimi**.
- Në vijim Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit për 3 gjyqtare **znj. Engjëllushe Tahiri, znj. Lorena Çabej, znj. Enisa Shahini** në pozicionet e **ndihmësmagjistratëve në Gjykatën e Lartë**.
- Këshilli miratoi vendimin për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**, për kandidaten **znj. Ina Hoxhaj**, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023.
- Këshilli miratoi vendimin për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**, për kandidatin **z. Ervin Sulaj**, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023.
- Në vijim, Këshilli miratoi vendimet për renditjen e kandidatëve në procedurën së lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr. 15, nr.17 dhe nr. 19, datë 18.01.2023.
- Në respektim të dispozitave ligjore, Këshilli vendosi për transferimin e gjyqtarëve **znj. Matilda Llangozi dhe znj. Nertila Kape** për shkak të lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë** si dhe të gjyqtarëve **z. Gjergji Baçi, zj. Thomaidha Roça dhe z. Artur Prenga** në procedurën e lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan**.
- Gjithashtu Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për **1 pozicion të lirë** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; për **1 pozicion të lirë** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; për **1 pozicion të lirë** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe për **1 pozicion të lirë** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Në vijim, Këshilli vendosi të transferojë në mënyrë të përkohshme gjyqtaren **znj. Suela Dashi** në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**, gjyqtarin **z. Ardit Kuka** në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan**, gjyqtarin **z. Arben Dosti** në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë** si dhe gjyqtarin **z. Ramiz Lala** në **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**.
- Këshilli vendosi për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe për ngritjen në detyrën e gjyqtarës të **Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të znj. Rudina Palloj**.
- Në kuadër të fillimit të procedurës së transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicioneve në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme, Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e projektvendimeve (për njohje të mëtejshme).

- Në fokus të veprimtarisë së tij gjatë këtyre muajve, Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata edhe përmes skemës së delegimit, në të cilën u përfshinë **2 gjyqtarë**.
- Gjithashtu Këshilli ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit për **1 gjyqtar**.
- Këshilli vendosi për hapjen e procedurës për komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kandidaturave nga rradhët e gjyqtarëve.
- Këshilli vendosi për komandimin e gjyqtarit **z. Gentian Jahjollli** në pozicionin e **Këshilltarit Juridik në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut**.
- Këshilli vendosi për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar në pozicionin "ndihmësmagjistrat" në Gjykatën Kushtetuese.
- Këshilli në përfundim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023 vendosi **emërimin 40 kandidatëve**.
- Në vijim, Këshilli vendosi shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 12.10.2023 dhe në përmbyllje të këtij procesi vendosi për caktimin në pozicion të **40 gjyqtarëve të emëruar**, si më poshtë:
 1. Znj. Ina Yzellari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 2. Z. Klajdi Tërova në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 3. Znj. Aurora Alimadhi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 4. Znj. Olta Cenaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 5. Z. Estjon Venxha në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 6. Znj. Edlira Çota në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 7. Z. Elvis Sulejmani në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 8. Z. Vladimir Cjapi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 9. Z. Noel Veizi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 10. Z. Renis Sheshi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 11. Z. Aldi Kareco në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 12. Z. Genci Busho në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 13. Z. Artan Çirraga në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 14. Znj. Alba Ngresi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 15. Znj. Dorentina Mulaj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë;
 16. Znj. Klodiana Kryeziu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 17. Znj. Eranda Cufo në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 18. Z. Armand Shkurta në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë;
 19. Z. Fjorald Behari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 20. Znj. Edona Vajushi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
 21. Znj. Eglantina Biba në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 22. Z. Mikel Hysometaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
 23. Znj. Dorina Alushi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 24. Z. Lirim Bulica në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 25. Znj. Juliana Pjetri në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 26. Znj. Egla Mirashi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 27. Znj. Nertila Përallaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
 28. Znj. Elona Mërtiri në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 29. Znj. Anisa Brinja në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 30. Znj. Elena Tafa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 31. Znj. Lumturi Zhupa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 32. Z. Ilirjan Hysa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 33. Znj. Entela Selmanaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
 34. Z. Entiljano Spahiu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
 35. Z. Ervin Kore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 36. Z. Romeo Merruko në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
 37. Znj. Mevlute Çausi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
 38. Z. Orald Hoxha në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
 39. Znj. Ajshe Xhafa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;

40. Znj. Enkeleda Halilaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të **40 kandidatëve fitues** në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024.
- Këshilli, në vijim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore përfshirë dhe pasurinë e figurën, të kandidatëve për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, profili gjyqtar, vendosi kualifikimin e **30 kandidatëve** dhe shtyrjen e trajtimit për **1 kandidat**.
- Këshilli, në përfundim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore përfshirë dhe pasurinë e figurën, të kandidatëve për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022 dhe vitit akademik 2022-2023 profili gjyqtar, vendosi për **1 s'kualifikimin për 1 kualifikimin** dhe shtyrjen e trajtimit për **1 kandidatë**.
- Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin e **znj. Romina Elezi** për pozicionin **këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe znj. Isabela Tafili** në pozicionin e **ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** si dhe ka vendosur për përfundimin pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit për pasurinë dhe figurën për **2 kandidatë** për në formimin fillestar në pozicionin e ndihmës ligjor.
- Këshilli miratoi vendimet përkatëse për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të **znj. Jona Biba** për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë **Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. Kristina Gaçe** si dhe **znj. Isabela Tafili**, për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë **Gjykatës Administrative të Apelit**.
- Nga ana e Këshillit kanë vijuar verifikimet dhe lejimin për marrjen pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarëve në detyrë. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli ka vendosur kualifikimin dhe lejimin për marrjen pjesë në provimin e vlerësimit profesional për **4 kancelarë**, skualifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës për **1 kancelar** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, si dhe është vendosur për shtyrjen e shqyrtimit të projektvendimit **për 1 kancelar**.

DISIPLINA DHE TRANSPARENCA



Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe, Këshilli ka vijuar me shqyrtimin në seancë dëgjimore publike të kërkesave së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimeve disiplinore nr. 4/2023 në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë {...}. Gjithashtu Këshilli, ka vendosur 2 shfuqizime të pezullimeve të procedimeve disiplinore, ka miratuar me vendim për përfundimin e procedimit disiplinor të filluar pa një vendim përfundimtar për **1 gjyqtar** si dhe ka vendosur për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar për **1 magjistrat**. Gjithashtu ka vendosur pezullimin e procedurës disiplinore të filluar ndaj 1 magjistrati deri në marrjen e formës së

prerë nga KPK.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor trajtoi **14 kërkesa për caktimin e 20 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta** në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimin për një ndryshim në vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat” duke caktuar:


- Z. Ardit Kuka, gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- Znj. Marjola Beluli, gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
- Znj. Dejvi Çelçima, gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
- Z. Renis Sheshi, gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
- Znj. Suela Lika, gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
- Z. Erjon Bani, gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në përputhje me detyrimet ligjore, Këshilli miratoi listën e gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2024.

KL Gj, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar **12 kërkesa për informacion**, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtorja e Marrëdhënive me Publikun, me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar **145 shkresa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

Veprimtaria e KL Gj-së (Tetor-Dhjetor 2023):



- 21 mbledhje plenare
- 236 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 12 akte kolektive, Tetor 2023
 - 6 akte kolektive, Nëntor 2023
 - 5 akte kolektive, Dhjetor 2023
 - 135 akte individuale, Tetor 2023
 - 37 akte individuale, Nëntor 2023
 - 26 akte individuale, Dhjetor 2023

Pjesa tjetër përfshihen 2 akte normative nënligjore dhe 13 rregulla të brendshme.



KLJGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

2800

-na ndiqni-

Adresa: Godina “Poli i Drëjtësisë”, Rruga”Ana Komnena”, Tiranë

www.klgj.al

e-mail: kontakt@klgj.al